


PROGRESI I REKOMANDIMEVE

të Këshillit të Investimeve

Korrik 2021

KËSHILLI I INVESTIMEVE (prill 2015 - korrik 2021)

Numri i rekomandimeve sipas temës (prill 2015 - korrik 2021)



24 Mbledhje


264 Totali i Rekomandimeve të Miratuara (Prill 2015 - Qershor 2021)

19 Rekomandime të Miratuara (Janar - Qershor 2021)


REKOMANDIME TË KI (prill 2015 - korrik 2021)

Rekomandime sipas kategorisë

Strategjike Ligjore Institucionale Transparencë Politika Ndërgjegjësim 0.4%



Rekomandimet sipas sektorit




ECURI POZITIVE NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË KI (prill 2015 - korrik 2021)

Aktualisht, **38%** e rekomandimeve totale janë të plotësuara, ndër të cilat gjatë *janar - korrik 2021* kemi identifikuar **progres pozitiv** në **15** rekomandime: **9** të zbatuara plotësisht ose pjesërisht dhe **6** në proces zbatimi.

MË KONKRETISHT:

- Zbatimi i detyrimit ligjor sipas nenit 25 paragrafi ç) të ligjit 68/2017 **për ndarjen e 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore.**
- **Priorizimi i digjitalizimit dhe përsheptimi i mbulimit kombëtar me brez të gjerë** - bazuar në një studim fizibiliteti me mbështetjen e WBIF dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë detajuar rajonet bazuar në përqendrimin e NVM-ve dhe zonat prioritare për shtrirjen e brezit të gjerë, si dhe skenarët më të favorshëm për shtrirje bazuar në modele ndërkombëtare. Gjithashtu, një buxhet specifik është miratuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) për të përsheptuar procesin e mbulimit me brez të gjerë.
- **Saktësimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore kombëtare referuar nivelit të përdorimit dhe aksesueshmërisë në TIK nga bizneset** - pas krijimit të një grupi pune dhe me një mbështetje teknike nga BERZH për MFE, u ndërmor një studim ku u përpunuan të dhëna mbi përdorimin e TIK nga NVM-të në Shqipëri dhe modele nga vendet e zhvilluara dhe rajoni që mund të konsiderohen për zbatim. Këto të dhëna u bazuan në indikatorë ndërkombëtarë si DESI dhe Eurostat ICT.

Implementuar Në Proçes Jo Implementuar



ECURI POZITIVE NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË KI (prill 2015 - korrik 2021)

-  **Rritja e aksesit të NVM-ve në TIK me fokus në nevojat specifike të NVM-ve. Thjeshtimi dhe koordinimi më i mirë i informacionit mbi projektet evropiane që mbështesin NVM-të** përmes përmbledhjes së skemave dhe donatorëve ekzistues nën një platformë të unifikuar: <https://e-brd2.dm-consulting.biz/> e cila po menaxhohet nga AIDA dhe MFE.
-  **Nxitja e tregtisë elektronike - formalizimi i saj ligjor, si një model potencial i ofrimit të shërbimeve/produkteve në mënyrë të qëndrueshme** - duke synuar promovimin e tregtisë elektronike nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka Botërore është ndërmarrë studimi "Diagnostikimi i tregtisë elektronike në Shqipëri duke shfrytëzuar dixhitalizimin" ku analizohet situata e tregtisë elektronike në Shqipëri dhe rajon. Masat e propozuara në këtë studim janë konsultuar në grupin teknik të punës "Lidhjet/aktivitetet dixhitale" mes ekspertëve të MFE dhe MIE dhe një plan specifik veprimi është krijuar për 2021-24, por ende nuk është publikuar dhe vënë në zbatim.
-  **Subvencionimi i naftës për fermerët si një instrument për të inkurajuar formalizimin e fermerëve dhe mbështetjen e investimeve të fermerëve** - është miratuar në janar 2021 dhe filluar zbatimin me 20,600 përfitues nga kjo skemë.



ECURI POZITIVE NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË KI (prill 2015 - korrik 2021)


- Mbështetja e tregtisë elektronike përmes konsiderimit të formave alternative të kleringut për transfertat lokale në Euro, me qëllim uljen e kostove të larta të ngarkuara nga rrjeti korrespondent bankar** - Banka e Shqipërisë ka njoftuar se me miratimin e ligjit "Për Shërbimet e Pagesave", ka filluar një transpozim i direktivës së dytë për Shërbimet e Pagesave të Bashkimit Evropian (PSD2), që konsiderohet si një arritje dhe përmbushje e një numri angazhimesh. Gjithashtu u confirmua se Sistemi i Klerimit ose Pagesave të Çastit në Euro pritet të hyjë në fuqi deri në fund të vitit 2021.
- Përsheptimi i tregtisë elektronike përmes identifikimit të qartë të aktorëve të tregtisë elektronike, operacionet dhe ndikimin e përgjithshëm të ekonomisë dixhitale në ekonominë shqiptare** - Identifikimi i aktorëve të inovacionit në Shqipëri është përfunduar tashmë nga MFE.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve kombëtare përmes vendosjes së standardeve për të gjitha shërbimet e ofruara në nivel lokal për qytetarët/biznesin bazuar në tregues konkretë dhe krijimi i një sistemi për matjen e performancës në nivel bashkie** - Përmes projektit STAR 2 është krijuar një metodologji e monitorimit të performancës e cila bazohet në një indeks të ndërtuar nga NALAS dhe i aplikuar në nivel rajonal, për të gjitha vendet në rajon. Treguesit e katalogut janë përshtatur për Shqipërinë dhe për aplikimin specifik në nivel bashkie.
- Lehtësimi i Tregut të Liberalizuar të Energjisë dhe funksionaliteti i Bursës së Energjisë** - Bursa e Energjisë- ALPEX është regjistruar tashmë në QKR, organet drejtuese janë përzgjedhur dhe është miratuar struktura organizative. Gjithashtu, është miratuar strategjia e biznesit për tre vitet e ardhshme, si dhe plani ekonomik për 2020-2021. Elementi më i rëndësishëm i tij është platforma e tregtimit elektronik për të cilën është hapur një tender dy herë për përzgjedhjen e subjektit që do të plotësojë kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.



REKOMANDIME TË PAPLOTËSUARA TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE (prill 2015 - korrik 2021)

Aktualisht janë
126 rekomandime
të paplotësuara
dhe **36 në proces**
të cilat paraqiten në
grafik sipas temave
përkatëse.

Rekomandime të paplotësuara sipas temës (në %)



RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula


Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbatjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council

 ALInvestCouncil

 Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).